



**RAPORTI VJETOR
MBI NGARKESËN E PUNËS 2021
SË PROKURORIVE**

Mars 2022

Ky raport është hartuar në përputhje me nenin 19 pika 1, të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, Prokurori i Përgjithshëm publikon, brenda muajit mars të çdo viti, raportin vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive për vitin kalendarik paraardhës, si dhe rekomandimet për përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së tyre.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” kanë sanksionuar se prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Prokuroria përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- c) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në vitin 2021, numri i përgjithshëm i miratuar është **321¹** prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Shpërndarja e tyre në prokuroritë sipas niveleve ka qenë: 278 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 26 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 17 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme. Ndërkohë, për shkak të vakancave numri faktik i prokurorëve ka qenë 177 në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 16 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 12 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, që krahasuar me vitin 2020² përbëjnë ulje përkatësisht prej 21.45 % të numrit faktik total të prokurorëve.

Në vitin 2021 numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës për secilin nivel prokurorie paraqitet:

1. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm:

¹ 15 prokurorë u emëruan në Prokurorinë e Posaçme.

² Numri faktik i prokurorëve në janar 2020 ka qenë 261, përkatësisht 236 në prokuroritë e shkallës parë, 15 në prokuroritë e apeleve dhe 10 në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë ³	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	80	52	58	48	48	71	69	199	169
Berat	7	3	5.25	7	6	8	8	22	17
Dibër	6	4	4	4	3	7	7	17	14
Durrës	27	21	22	13	13	23	21	63	55
Elbasan	25	17	20.50	13	13	19	19	57	49
Gjirokastrë	7	4	4	5	5	11	11	23	20
Fier	14	12	13	11	9	17	17	42	38
Korçë	13	7	7.50	11	8	19	19	43	34
Krujë	7	5	4.75	5	5	5	5	17	15
Kukës	5	2	3.50	3	3	7	7	15	12
Lushnje	7	3	4.50	4	4	9	9	20	16
Lezhë	10	5	5.50	6	6	11	11	27	22
Mat	3	2	1.75	2	2	4	3	9	7
Përmet	2	1	1	1	1	4	3	7	5
Pukë	2	2	2	1	1	4	4	7	7

³ Llogaritja e numrit efektiv është bërë sipas kohës reale të punës së prokurorit në prokurorinë përkatëse, ku:

Me pak se një muaj (30 dite) =0 prokuror

Nga 1 në 3 muaj=0,25 prokuror

Nga 4 në 6 muaj=0,5 prokuror

Nga 7 në 9 muaj=0,75/prokuror

Nga 10 në 12 muaj=1 prokuror

Pogradec	4	3	3.25	3	3	6	6	13	12
Sarandë	7	4	4.50	3	3	7	6	17	13
Shkodër	19	11	10.50	13	13	21	21	53	45
Tropojë	3	1	1.50	1	1	4	4	8	6
Vlorë	19	13	14	14	14	17	17	50	44
Kavajë	7	3	4.25	3	3	6	6	16	12
Kurbin	4	2	2	3	3	6	6	13	11

2. Në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

Prokuroritë pranë gjykatave të apelit	Prokurorë			Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	9	5	3.25	10	10	17	13
Durrës	4	4	3.50	4	4	8	7
Gjirokastrë	2	1	1	2	2	4	3
Vlorë	5	2	1.75	4	4	9	8
Shkodër	4	2	2	3	3	8	6
Korçë	2	2	2	2	2	4	4

3. Në Prokurorinë e Përgjithshme:

Prokuroria e Përgjithshme	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
	17	12	11.5	42	34	80	70	148	116


Duke iu referuar të dhënave statistikore vjetore të përcjella nga prokuroritë, volumi i punës dhe ngarkesa mesatare analizohet në vijim:

I. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

I.1 Volumi në hetim

Volumi i punës në hetim në shkallë vendi

Gjatë vitit 2021, në organin e prokurorisë janë trajtuar 60976⁴ materiale kallëzuese që përbën një rritje prej 4.2 % në krahasim me vitin 2020. Janë ndjekur gjithsej 47475 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 5.89 % në krahasim me vitin 2020, nga të cilat 28349 janë procedime penale të regjistruara, me një rritje prej 1.64 % në krahasim me vitin 2020 dhe 934 procedime penale të rifilluara, që tregon rritje prej 45.93 % në krahasim me vitin 2020. Janë mbartur, 18192 procedime penale me një rritje prej 11.57 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2020. Është vendosur mosfillimi për 13501 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 0.97 % në krahasim me vitin 2020.




⁴ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2021 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2021; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2021.

Volumi në hetim ku përfshihen çështjet e mbartura, çështjet e regjistruara, çështjet e rifilluara dhe ato të mosfilluara, për vitin 2021 sipas prokurorive është si më poshtë:

Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë ndjekur 2664 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë ndjekur 1568 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë ndjekur 5996 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë ndjekur 3740 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë ndjekur 2958 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastër janë ndjekur 1861 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë ndjekur 1144 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë ndjekur 2951 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë ndjekur 1539 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë ndjekur 956 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë ndjekur 966 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë ndjekur 1934 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnjë janë ndjekur 1757 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë ndjekur 286 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë ndjekur 231 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë ndjekur 970 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë ndjekur 265 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë ndjekur 2114 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë ndjekur 3541 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë ndjekur 18290 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë ndjekur 523 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë ndjekur 4722 çështje.


Grafikisht këto të dhëna paraqiten si vijon:



Volumi në hetim 2021



Në vitin 2021 raporti i numrit të çështjeve në hetim me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve, sipas prokurorive paraqitet në grafikët në vijim:

Ngarkesa mesatare në hetim për çdo prokuror sipas numrit organik






I.2 Sipas prokurorive të shkallës së parë, numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2021 është si vijon:


Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë regjistruar 942 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë regjistruar 551 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 2483 procedime penale;

Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 1960 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 1420 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë janë regjistruar 660 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë regjistruar 549 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 1183 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë regjistruar 690 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë regjistruar 553 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë regjistruar 455 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 1213 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnjë janë regjistruar 918 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë regjistruar 169 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë regjistruar 141 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë regjistruar 514 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë regjistruar 71 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 732 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 1614 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë që është prokuroria me ngarkesën më të madhe në vend, janë regjistruar 9149 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë regjistruar 282 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 2100 procedime penale.


Grafiku më poshtë paraqet të dhënat mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2021:




Ndërkohë, numri i të pandehurve/personave nën hetim të regjistruar në prokuroritë e shkallës së parë, paraqitet në grafikun më poshtë:





Raporti i numrit mesatar të çështjeve të regjistruara sipas numrit organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve sipas prokurorive paraqitet në vijim:







I.3 Në analizë të përqindjes që zënë procedimet e regjistruara dhe procedimet e mbartura në volumin e punës sipas prokurorive, të dhënat rezultojnë si më poshtë:



I.4 Në analizë të përqindjes që zënë raporti i procedimeve të përfunduara me çështjet e regjistruara dhe procedimeve të përfunduara me procedimet në ndjekje sipas prokurorive, të dhënat rezultojnë si më poshtë:



II. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës ka shqyrtuar 359 çështje themeli dhe 337 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka shqyrtuar 130 çështje themeli dhe 135 çështje lidhur me masat e sigurimit;


Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë ka shqyrtuar 108 çështje themeli dhe 230 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka shqyrtuar 259 çështje themeli dhe 389 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka shqyrtuar 349 çështje themeli dhe 1149 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka shqyrtuar 286 çështje themeli dhe 534 çështje lidhur me masat e sigurimit.

Grafikisht të dhënat paraqiten si vijon, ku siç vërehet Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë edhe për vitin 2021 ka patur ngarkesën më të madhe:



Raporti i numrit mesatar të çështjeve me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve sipas prokurorisë përkatëse paraqitet në vijim:


Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit organik



Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit faktik



Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit efektiv



III. Ngarkesa e punës së Prokurorisë së Përgjithshme

III.1 Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit shqiptar pranë Gjykatës së Lartë për 54 çështje, prej të cilave 34 gjykime themeli, ku tre janë për vendime njësuese, dhe 20 gjykime masa sigurimi, si dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 5 çështje.

III.2 Mosmarrëveshje për kompetencë

Gjatë vitit 2021 janë marrë 49 vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën tokësore apo lëndore në hetimit paraprak të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

III.3 Në përmbushje të objektivave prioritare të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021 dhe në kuadrin e kërkesave dhe rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe ndërkombëtare, janë përgatitur akte normative të Prokurorit të Përgjithshëm, ku përfshihen 10 (dhjetë) udhëzime të përgjithshme, 15 (pesëmbëdhjet) urdhëra normativ dhe 4 (katër) marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale, me synim realizimin e misionit kushtetues dhe ligjor të prokurorisë, forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e mëtejshme të efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjes dhe përfaqësimit të çështjeve dhe akuzave në gjyq, për krime të rënda e sensitive, në respektim të të drejtave të ligjshme dhe lirive personale të individit e viktimave në procesin penal, duke garantuar pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve.

III.4 Dekriminalizimi

Në Sektorin e Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për vitin 2021 janë regjistruar 181 procese të verifikimit të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklaruar të personave, subjekt i këtij ligji.

Gjatë kësaj periudhe, për 118 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 63 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me këto kërkesa/procese të regjistruara më vitin 2021, për 58 persona, kërkesat janë kthyer pasi nuk plotësonin kushtet e përcaktuara në ligj, ndërsa për 60 persona, procesi ka përfunduar gjatë vitit 2021, duke miratuar rezultatet e verifikimit.

III.5 Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2021, ka trajtuar:

- Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit, në total 128 praktika dhe janë përfunduar gjithsej 81 praktika;
- Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë, në total 117 praktika, të përfunduara 36;
- Urdhër arreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, në total 299 praktika;
- Letërporosi nga Jashtë, në total 599 praktika, 397 të përfunduara;
- Letërporosi për jashtë, 655 praktika, 209 të përfunduara;
- Shpallje e shtetasve shqiptarë ose të huaj në kërkim ndërkombëtar, 172 praktika;
- Heqje e shtetasve shqiptarë nga kërkimi ndërkombëtar 133 praktika;
- Transferime të dënuarish nga jashtë, 2 praktika të reja;
- Transferime të dënuarish për jashtë 7 praktika në total;
- Transferim procedimi nga jashtë drejt Shqipërisë, 11 praktika;
- Transferim procedimi nga Shqipëria për jashtë, 13 praktika;
- Njohjet e vendimeve penale të ardhura nga jashtë, 40 praktika;
- Njohjet e vendimeve penale shqiptare të dërguara jashtë vendit, 14 praktika;
- Praktika të tjera 700 në total ku përfshihen dhënie mendimi për projektligje të ndryshme, kontributet për raporte, kërkesa për informacion nga subjekte etj.

III.6 Përgjimet

Gjatë vitit 2021 është përdorur përgjimi i komunikimeve elektronike nga prokurorët në fazën e hetimeve paraprake si mjet për sigurimin e provës në 655 procedime penale. Është realizuar përgjimi për 3664 paisje fundore në përdorim të 3412 subjekteve ndaj të cilëve ishte lejuar përgjimi.


Në 683 raste përgjimi është urdhëruar/autorizuar nga vetë prokurori, bazuar në nenin 222, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.

Në total janë ekzekutuar nga Bërthama Komanduese Elektronike 1534 vendime të Gjykatës nga të cilat 610 janë vendime lejimi përgjimi marrë mbi kërkesën e prokurorit; 455 raste janë vendime të gjykatës e cila ka vleftësuar kërkesën e prokurorit për rastet kur është aplikuar neni 222, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, në 469 raste është miratuar nga gjykata zgjatja e afatit të lejimit të përgjimit dhe vetëm në 2 raste gjykata ka refuzuar kërkesën e prokurorit për lejimin e përgjimit. Në 58 raste të lejimit të përgjimit, vetë prokurori ka urdhëruar ndërprerjen e tij me akt të motivuar.

Në përballje me volumin më sipër, oficerët e policisë gjyqësore të sektorit kanë mundësuar përgjimin dhe në përfundim rezulton të jenë prodhuar 14.364 procesverbale transkriptimi të shoqëruara nga 3505 CD/DVD.

IV. Ngarkesa në pesë vitet e fundit

Volumi në hetim në shkallë vendi në pesë vitet e fundit, paraqitet grafikisht në vijim:



Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa në hetim	2017	2018	2019	2020	2021
Berat	Volumi në hetim	2122	1898	2212	2176	2664
	Numri i prokurorëve	6	6	6	7	7
	Mesatarja për prokuror	354	316	369	311	381
Dibër	Volumi në hetim	1228	987	943	1178	1568
	Numri i prokurorëve	6	6	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	205	165	157	196	261
Durrës	Volumi në hetim	4678	5152	5812	5631	5996
	Numri i prokurorëve	26	26	26	27	27
	Mesatarja për prokuror	180	198	224	209	222
Elbasan	Volumi në hetim	3815	3788	4294	4341	3740

	Numri i prokurorëve	25	25	25	25	25
	Mesatarja për prokuror	153	152	172	174	150
	Volumi në hetim	2621	2871	2864	2705	2958
Fier	Numri i prokurorëve	14	14	14	14	14
	Mesatarja për prokuror	187	205	205	193	211
	Volumi në hetim	1577	1483	1786	1955	1861
Gjirokastrë	Numri i prokurorëve	5	5	5	7	7
	Mesatarja për prokuror	315	297	357	279	266
	Volumi në hetim	1171	1047	1101	1050	1144
Kavajë	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	167	150	157	150	163
	Volumi në hetim	2465	2791	2864	2740	2951
Korçë	Numri i prokurorëve	13	13	13	13	13
	Mesatarja për prokuror	190	215	220	211	227
	Volumi në hetim	1051	1172	1335	1777	1539
Krujë	Numri i prokurorëve	6	6	6	7	7
	Mesatarja për prokuror	175	195	223	254	220
	Volumi në hetim	781	699	666	808	956
Kukës	Numri i prokurorëve	4	4	4	5	5
	Mesatarja për prokuror	195	175	167	162	291
	Volumi në hetim	919	899	898	811	966
Kurbin	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	230	225	225	203	249
	Volumi në hetim	1868	2127	1723	1686	1934
Lezhë	Numri i prokurorëve	10	10	10	10	10

	Mesatarja për prokuror	187	213	172	169	169
	Volumi në hetim	1791	1617	1791	1620	1620
Lushnje	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	256	231	256	231	193
	Volumi në hetim	445	360	340	287	286
Mat	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	148	120	113	96	95
	Volumi në hetim	240	214	224	301	231
Përmet	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	120	107	112	151	115
	Volumi në hetim	947	1034	1012	937	970
Pogradec	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	237	259	253	234	243
	Volumi në hetim	280	230	299	178	265
Pukë	Numri i prokurorëve	3	3	3	2	2
	Mesatarja për prokuror	93	77	100	89	132
	Volumi në hetim	1761	1849	2276	2241	2114
Sarandë	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	7
	Mesatarja për prokuror	321	352	370	455	302
	Volumi në hetim	4526	3654	3357	3004	3541
Shkodër	Numri i prokurorëve	19	19	19	19	19
	Mesatarja për prokuror	238	192	177	158	186
	Volumi në hetim	18452	19541	18924	19168	18290
Tiranë	Numri i prokurorëve	78	77	77	77	80
	Mesatarja për prokuror	237	254	246	249	239

	Volumi në hetim	415	431	447	390	523
Tropojë	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	138	144	149	130	174
	Volumi në hetim	4458	4183	4121	4091	4722
Vlorë	Numri i prokurorëve	20	20	20	20	19
	Mesatarja për prokuror	223	209	206	205	249

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e Apelit	Ngarkesa	2017	2018	2019	2020	2021
	Volumi	1182	761	761	596	696
Durrës	Numri i prokurorëve	5	5	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	236	152	190	149	68
	Volumi	318	238	193	211	265
Gjirokastrë	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	159	119	97	106	348
	Volumi	469	405	274	360	338
Korçë	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	235	203	137	180	324
	Volumi	1110	1279	670	470	648
Shkodër	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4

	Mesatarja për prokuror	278	320	168	118	84
	Volumi	3200	3113	2085	1288	1488
Tiranë	Numri i prokurorëve	9	9	9	9	9
	Mesatarja për prokuror	356	346	232	143	166
	Volumi	1261	1001	821	666	820
Vlorë	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	252	200	164	133	164

Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa në hetim	2017	2018	2019	2020	2021
	Volumi në hetim	2122	1898	2212	2176	2664
Berat	Numri i prokurorëve	6	6	5	7	3
	Mesatarja për prokuror	354	316	442	311	888
	Volumi në hetim	1228	987	943	1178	1568
Dibër	Numri i prokurorëve	6	6	6	4	4
	Mesatarja për prokuror	205	165	157	295	392
	Volumi në hetim	4678	5152	5812	5631	5996
Durrës	Numri i prokurorëve	25	25	26	23	21
	Mesatarja për prokuror	187	206	224	245	286
Elbasan	Volumi në hetim	3815	3788	4294	4341	3740

	Numri i prokurorëve	25	25	25	20	17
	Mesatarja për prokuror	153	152	172	217	220
	Volumi në hetim	2621	2871	2864	2705	2958
Fier	Numri i prokurorëve	14	14	14	13	12
	Mesatarja për prokuror	187	205	205	208	247
	Volumi në hetim	1577	1483	1786	1955	1861
Gjirokastrë	Numri i prokurorëve	5	5	5	4	4
	Mesatarja për prokuror	315	297	357	489	465
	Volumi në hetim	1171	1047	1101	1050	1144
Kavajë	Numri i prokurorëve	6	6	6	6	3
	Mesatarja për prokuror	195	175	184	175	381
	Volumi në hetim	2465	2791	2864	2740	2951
Korçë	Numri i prokurorëve	11	11	11	10	7
	Mesatarja për prokuror	224	254	260	274	422
	Volumi në hetim	1051	1172	1335	1777	1539
Krujë	Numri i prokurorëve	5	5	4	5	5
	Mesatarja për prokuror	210	234	334	355	307
	Volumi në hetim	781	699	666	808	956
Kukës	Numri i prokurorëve	3	3	4	4	2
	Mesatarja për prokuror	260	233	167	202	478
	Volumi në hetim	919	899	898	811	966
Kurbin	Numri i prokurorëve	4	4	4	3	2
	Mesatarja për prokuror	230	225	225	270	483
	Volumi në hetim	1868	2127	1723	1686	1934
Lezhë	Numri i prokurorëve	10	10	9	8	5

	Mesatarja për prokuror	187	213	191	211	386
	Volumi në hetim	1791	1617	1791	1620	1620
Lushnje	Numri i prokurorëve	7	7	7	6	3
	Mesatarja për prokuror	256	231	256	270	586
	Volumi në hetim	445	360	340	287	286
Mat	Numri i prokurorëve	3	3	3	1	2
	Mesatarja për prokuror	148	120	113	287	143
	Volumi në hetim	240	214	224	301	231
Përmet	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	1
	Mesatarja për prokuror	120	107	112	151	143
	Volumi në hetim	947	1034	1012	937	970
Pogradec	Numri i prokurorëve	4	4	4	3	3
	Mesatarja për prokuror	237	259	253	312	323
	Volumi në hetim	280	230	299	178	265
Pukë	Numri i prokurorëve	2	2	3	2	2
	Mesatarja për prokuror	140	115	100	89	265
	Volumi në hetim	1761	1849	2276	2241	2114
Sarandë	Numri i prokurorëve	5	5	5	6	4
	Mesatarja për prokuror	352	370	455	374	705
	Volumi në hetim	3654	3357	3004	3611	3541
Shkodër	Numri i prokurorëve	19	19	18	15	11
	Mesatarja për prokuror	192	177	167	241	354
	Volumi në hetim	19541	18924	19168	17824	18290
Tiranë	Numri i prokurorëve	76	76	77	62	52
	Mesatarja për prokuror	257	249	249	287	352

Raporti vjetor

Mbi ngarkesën e punës së prokurorive

2021

	Volumi në hetim	431	447	390	438	523
Tropojë	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	1
	Mesatarja për prokuror	144	149	130	146	523
	Volumi në hetim	4183	4121	4091	4171	4722
Vlorë	Numri i prokurorëve	18	18	18	16	13
	Mesatarja për prokuror	232	229	227	261	393

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e Apelit	Ngarkesa	2017	2018	2019	2020	2021
	Volumi	1182	761	761	596	696
Durrës	Numri i prokurorëve	5	5	3	3	4
	Mesatarja për prokuror	236	152	254	199	174
	Volumi	318	238	193	211	265
Gjirokastrë	Numri i prokurorëve	2	2	2	1	1
	Mesatarja për prokuror	159	119	97	211	265
	Volumi	469	405	274	360	338
Korçë	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	235	203	137	180	169
	Volumi	1110	1279	670	470	648
Shkodër	Numri i prokurorëve	4	4	2	2	2

	Mesatarja për prokuror	278	320	335	235	324
	Volumi	3200	3113	2085	1288	1488
Tiranë	Numri i prokurorëve	9	9	7	6	5
	Mesatarja për prokuror	356	346	298	215	461
	Volumi	1261	1001	281	666	820
Vlorë	Numri i prokurorëve	5	5	4	4	2
	Mesatarja për prokuror	252	200	70	167	469

V. Rekomandime

Në vitin 2022, me qëllim përmirësimin e strukturave dhe kapaciteteve institucionale e profesionale si dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së prokurorisë, rekomandohet:

1. Forcimi i kapaciteteve institucionale për rritjen e efikasitetit në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe i kapaciteteve profesionale për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së prokurorëve dhe policisë gjyqësore në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve:

1.1 Puna e nisur përgjatë vitit 2021 me shtimin në organik të numrit të oficerëve të policisë gjyqësore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, të vijoje më tej për kryerjen e procedurave të përzgjedhjes për emërimin e tyre sipas nevojave në prokuroritë përkatëse, me synim për të vijuar lehtësimi dhe mbështetja e prokurorëve në përballimin e volumit të punës në rritje të procedimeve të regjistruara dhe në ndjekje në fazën e hetimeve si dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar në prokuroritë përkatëse.

1.2 Vijimi i bashkërendimit dhe koordinimit me KLP dhe Shkollën e Magjistraturës, për të planifikuar më në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magjistrat/prokuror sipas ligjit, me synim për të shmangur rritjen progresive të numrit organik të prokurorëve që i mungojnë sistemit të prokurorisë në të tre nivelet pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Rritja më tej e veprimtarisë monitoruese për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme⁵ dhe e bashkëpunimit me ILD dhe KLP në drejtim të koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informacionit, identifikimit të shkeljeve disiplinore apo etike dhe problemeve të performancës së zyrave të prokurorive, nëpërmjet aktiviteteve;

2.1 Vijimi i qasjes proaktive nga strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme në bashkërendim me drejtuesit e prokurorive, me prioritet mbledhjen dhe analizën e informacionit të përftuar për problematikat e evidentuara, në funksion të rritjes së monitorimit, koordinimit dhe bashkëpunimit institucional dhe ndërinstitutional, si dhe sigurimin/garantimin e zbatimit të parimit të funksionalitetit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm;

2.2 Rritja më tej e kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorive nëpërmjet kërkimit dhe vlerësimit të informacioneve periodike nga drejtuesit e prokurorive;

2.3 Rritja e efikasitetit të koordinimit dhe monitorimit të veprimtarisë së strukturave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme me drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme apo akteve të tjera normative, planeve të veprimit dhe/ose strategjive institucionale apo ndërinstitutionale, të fokusura për zbatimin e rezolutave dhe/ose rekomandimeve të institucioneve kushtetuese ose ndërkombëtare sipas ligjit.

3. Të vijojë puna për të shmangur efektet negative të vakancave nga ulja e numrit të prokurorëve në kuadrin e procesit të rivlerësimit kalimtar:

3.1. Të rishikohen strukturat organike dhe faktike në prokuroritë që kanë rritje të numrit të procedimeve mbi nivelin mesatar të ngarkesës efektive për prokuror dhe t'i kërkohet KLP kryerja e transferimeve të përkohshme të nevojshme në prokuroritë përkatëse, për të normalizuar veprimtarinë në prokuroritë përkatëse.

4. Puna e nisur dhe marrja e masave konkrete të propozuara lidhur me prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, për të mundësuar dixhitalizimin, të vijojë me prioritetet:

4.1 Prokuroria e Përgjithshme në bashkërendim me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë KLGJ të vijojnë punën për vlerësimin e kapaciteteve humane, teknologjike dhe marrjen e masave të tjera për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori me standardet aktuale⁶.

4.2 Puna e nisur për sistemin elektronik PRESTO me mbështetjen e Projektit EURALIUS V e pa përfunduar, të vijojë me tej për zhvillimin dhe përfundimin e këtij sistemi për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave

⁵ Shih, pikën 2 të nenit 6 dhe pikën 1 të nenit 46 në lidhje me nenin 2 shkronja “c” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh”, ku parashikohet se, udhëzimet e përgjithshme dhe të arsyetuara me shkrim të prokurorëve më të lartë janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët.

⁶ Shih, masa/aktivitetit 4.1.7 në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë për vitet 2022-2025, miratuar me 24.12.2021.

në kohë reale me të dhëna gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

5. Të vijojë rritja më tej e efikasitetit të bashkërendimit dhe koordinimit me Komisionin e Policisë Gjyqësore, për forcimin e kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore në strukturat përkatëse të shërbimeve dhe seksioneve të policisë gjyqësore, me synim rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e hetimeve në drejtimet prioritare të luftës kundër kriminalitetit në zbatim të kuadrit ligjor.

6. Në kuadrin e miratimit të hartës së re gjyqësore rritja e kapaciteteve akomoduese me ambiente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, administratën dhe shërbimet mbështetëse në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, dhe përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës në prokurori, forcimin e kapaciteteve institucionale e profesionale dhe për sigurimin e aksesit të shtetasve në prokurori.